



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 53, datë 20.04.2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 471, DATË 23.12.2017 “PËR MIRATIMIN E LINJAVE RRETHQYTETASE TË TRANSPORTIT PUBLIK PËR TERRITORIN E BASHKISË DURRËS, INTINERARIN, STACIONET DHE ORARET E TYRE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit ” i ndryshuar, VKB-së Nr. 471, datë 23.12.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetase të transportit publik për territorin e Bashkisë Durrës, intinerarin, stacionet dhe oraret e tyre”, VKB-së nr. 489, datë 23.04.2018 ”Për një ndryshim në VKB-në nr. 471, datë 23.12.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetase të transportit publik për territorin e Bashkisë Durrës, intinerarin, stacionet dhe oraret e tyre”, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit në pikën I, përsa i përket itinerarit, stacioneve dhe oraret e tyre të linjave rrethqytetase të transportit publik për territorin e Bashkisë Durrës, si më poshtë vijon:

- Për Njësinë Administrative Manëz, Linja 21 ndryshon si më poshtë:

- Itinerari: Linja nr.21 Manëz – Durrës – Manëz me kalim nga autostrada.
- Stacionet : 1. Manëz. 2. Kullë. 3. Kthesa e Ariut. 4. Vadardhë. 5. Autostradë Stacioni i Trenit Durrës.
- Oraret e nisjes: 06.30 – 08.30 – 09.00 – 09.30 – 10.30 - 13.15 – 16.30.
- Oraret e kthimit: 07.30 – 08.30 – 11.15 – 12.15 – 13.30 – 15.00 – 17.00.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve.


3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 92/prot.
2



Durrës, më 21.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 53, datë 20.04.2021 Për një ndryshim në VKB Nr. 471, datë 23.12.2017 “Për miratimin e linjave rrethqytetase të transportit publik për territorin e Bashkisë Durrës, intinerarin, stacionet dhe oraret e tyre”, i ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

